

**AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ANDROMEDA” SH.P.K**

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

Neni 1

Data e Themelimit, Emërtimi dhe Themeluesit

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 7850, dt. 29.07.1994 “Kodi Civil i RSH”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”:

1. Më datë 12.02.2025 miratohet Statuti dhe Akti i Themelimit i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.
2. Themeluesit e shoqërisë janë:
 - **Z. Skerdilajd Faria**, shtetas Shqiptar, atësia Late, lindur më 21.09.1971 në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rr. “Dritan Hoxha”, Pallati Green Construction, mbajtës i Pasaportës nr. BC3504021, me Nr. Personal H10921036C, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2

Objekti

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Import -Eksport të materialeve dhe pajisjeve dentare, farmaceutike, mjekësore. Import - Eksport të medikamenteve të ndryshme mjekësore dhe farmaceutike. Ushtrimin e aktivitetit privat me hapjen e farmaceve, qendrave shëndetësore, poliklinikës dentare, ekografi, laboratorë dentare dhe mjekësore si dhe aktivitete të ndryshme në fushën e mjekësisë dhe stomatologjisë. Të ofrojë aktivitete të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë. Shitje, blerje me shumicë dhe pakicë të pajisjeve dhe materialeve dentare dhe mjekësore. Veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese –gjeneratore me rreze X. Në fushën e mjekësisë dhe shëndetit:

- Ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe spitalore ditore i Klases B jopublike. Ambulator mjekësor. Diagnostikim mjekësor dhe kirurgjikal.
- Ofrimin e shërbimit të trajtimeve estetike, ndërhyrjeve, kirurgjisë, mjekësisë estetike (rinoplastikë, lifting i fytyrës, rimodelim i mjekrës, liposuksion , rimodelim i buzëve, trajtim me multivitamina, filler për rrudhat, PRP për fytyrën dhe për flokët, gummy smile.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një afat të pacaktuar.



Neni 4
Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga "Dritan Hoxha", Pallati Green Construction, Shk. II, Kati III, Tiranë.

Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose filiale brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

KREU II
KAPITALI

Neni 5
Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1,000 (njëmijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:
 - **Z. Skerdilajd Faria** me vlerë 1,000 (njëmijë) Lekë, e cila përbën 100% të Kapitalit të Shoqërisë.
- 2) Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin e saj deri në kufirin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Aksionarëve.
- 3) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga Asambleja e Ortakëve e një eksperti të autorizuar për këto kontribute. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
- 2) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 3) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqëson.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

- 1) Kuotat e kapitalit të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - i. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - ii. shitblerjes;
 - iii. trashëgimisë;
 - iv. dhurimit;
 - v. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU III
ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarrës

- 1) Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Mbledhja dhe Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike të vetëdeklaruar prej aksionerëve. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 3) Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut, sa herë që është e nevojshme mbledhja e saj për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
- 4) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga çdo ortak, i cili përfaqëson të paktën 25% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë, në respektim të parashikimeve të neneve 83 dhe 84 të ligjit Nr. 9901, datë 14.01.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".



- 5) Ortaku do të njoftohet për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me anë të një letre të porositur (rekomande) ose postës elektronike.

Ortakët janë të detyruar që të depozitojnë me shkrim pranë administratorit të shoqërisë adresën në të cilën do t'i dërgohet njoftimi nga Shoqëria me anë të letrës së porositur (rekomande), si dhe adresën e postës elektronike ku do ti dërgohet njoftimi. Dërgimi i njoftimit në këto adresa do të konsiderohet si njoftim i kryer rregullisht.

- 6) Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.
- 7) Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrës së mësipërme ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët e shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje ose të përfaqësuar dhe janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë së thirrjes.
- 8) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në zyrën qendrore (selinë) të shoqërisë ose në një vend tjetër të përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10

Kuorumi

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përfundimi nga e drejta e votës

- 1) Ortakët nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;

Faqe 4 e 8

**Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
"ANDROMEDA" SH.P.K**

- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortakut përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakut, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet **znj. Fatushe Kruja**, shtetase Shqiptare, lindur më 27.01.1994 në Peqin dhe banuese në Tiranë, identifikuar me Pasaportë Nr. BR5015470, Nr. Personal J45127014Q, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e vendimit të emërimit nga ortakut i vetëm i Shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 14
Kompetencat e Administratorit/ëve

- 1) Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratori/ët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.



Neni 15
Përgjegjësitë e Administratorit

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 8) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



KREU IV

VITI FINANCIAR, EKSPERTËT

Neni 16

Viti Financiar

- 1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

- 1) Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko- tregtar të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla i ngarkuar nga ana e ortakut/ëve.
- 2) Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut/ëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

- 1) Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
 - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.
- 5) Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

O R T A K Ë T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ANDROMEDA" SH.P.K

Stendi/gjohi Fonda
